



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUIQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

Raporti Vjetor 2024

*Një vitë plot bashkëpunim dhe
përkushtim!*

Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!

Donatorët, projektet dhe shërbimet



Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës - Brot für die Welt



Fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjve, që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet aktiviteteve bujqësore dhe përpunimit të ushqimit



Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë



Fuqizimi i Ekonomive Rurale në Bujqësi (EREA)



Farat e fuqizimit – gratë në bujqësi



Aktiviteti i USAID-it për zhvillimin e fuqisë punëtore të udhëhequr nga sektori privat



Promovimi ekonomik për të stabilizuar tregun e punës - Forcimi Zinxhirit të Vlerës përmes Zhvillimit të aftësive





***E ardhmja e ushqimit fillon me
dorën e fermerit!***

Të nderuar lexues, bashkëpunëtorë dhe partnerë të IADK-së,

Me krenari ju prezantoj Raportin Vjetor 2024, një përmbledhje e arritjeve tona, sfidave dhe angazhimit të vazhdueshëm për zhvillimin socio-ekonomik të zonave rurale në Kosovë. Ky vit shënon një moment të veçantë për organizatën tonë –

20-vjetorin e themelimit të IADK-së. Kjo përvojë dydekadëshe ka qënë një rrugëtim i mbushur me sfida dhe suksese, gjithmonë në shërbim të fermerëve-komuniteteve tona rurale.

Themeluar nga një grup entuziastësh që besonin fuqimisht në potencialin e zhvillimit të bujqësisë, IADK ka ndërthurrur njohuritë, eksperiencat dhe pasionin për të kontribuar në zvogëlimin e papunësisë, krijimin e mundësive për të ardhura dhe mbështetjen e fermerëve të vegjël.

Gjatë këtij viti, ne kemi përmbushur një prej objektivave tona më të rëndësishme duke kompletuar fermën për demonstrim praktik në oborrin e IADK-se. Kjo fermë ofron mësim të vlefshme për fermerët në fushën e pemëtarisë, perimeve dhe bimëve mjekësore, duke ndihmuar në ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve profesionale të tyre.

Viti 2024, megjithatë, nuk ka kaluar pa sfida. Ndryshimet klimatike kanë ndikuar dukshëm në sektorin e bujqësisë, duke shkaktuar humbje dhe ulje të rendimenteve. Kjo situatë na kujton urgjencën e adresimit të këtyre sfidave dhe nevojën për veprime të koordinuara për të mbrojtur dhe zhvilluar bujqësinë në Kosovë.

Kontributi ynë këtë vit ka qënë i përkushtuar posaçërisht për mbështetjen e fermerëve të vegjël, grave, vajzave dhe komuniteteve jo-shumicë. Falë bashkëpunimit me partnerët tanë strategjikë dhe mbështetjes së donatorëve tanë, kemi arritur të zbatojmë projekte që jo vetëm kontribuan në zhvillimin rural, por edhe në fuqizimin ekonomik dhe social të grupeve më të ndjeshme.

Dua të shpreh mirënjohjen time të thellë ndaj Bordit Drejtues të IADK-së, ekipit tim të përkushtuar, përfituesve që na kanë besuar dhe kanë shënuar rezultate të shkëlqyera, si dhe donatorëve që kanë mbështetur vizionin dhe misionin tonë.

Çdo hap që kemi marrë, çdo arritje e vogël apo e madhe, ka qënë rezultat i përpjekjeve të përbashkëta dhe besimit tuaj. Së bashku, do të vazhdojmë të punojmë për një të ardhme më të mirë për zonat rurale të Kosovës.

Me respekt,
Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv i IADK-së

Përmbajtja

Fushëveprim Ynë	5
Puna jonë në numra	6
Sektori i Perimeve, një thesar për zhvillim të bujqësisë	8
Kultivimi i pemëve një mundësi e arte për punësim dhe gjenerim të ardhurave	10
Sektori i Blegtorisë	12
Sektori i Përpunimit të Ushqimit	14
Përfshirja Gjimore	16
Vizita Studimore	18
Panaire	19
Përfshirja e Komuniteteve jo Shumicë	20
Fuqizimi teknik dhe profesional i organizatës IADK	21
Praktikat dhe Punësimi i Studentëve	22
Ngritja e Kapaciteteve Profesionale të Stafit përmes Trajnimeve mbi Barazinë Gjimore	24
Trajnime për Menaxhimin e Rezistencës ndaj Ndryshimeve Klimatike	25
Shërbimet e ofruara nga IADK	26
Partneritetet ndërkombëtare	27
Shpënzimet e IADK-së nga projektet dhe grantet	28
Të hyrat e IADK-së nga shërbimet	29
Mirënjohje për stafin	30

Fushëveprimi Ynë

IADK ka pasur një angazhim të vazhdueshëm në mbështetjen dhe fuqizimin e fermerëve, grave, burrave, të rinjve dhe të rejave në disa komuna të Kosovës, duke zbatuar projekte që adresojnë nevojat e tyre dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të komuniteteve rurale. Në shumë prej këtyre komunave, IADK ka zbatuar më shumë se një projekt, duke thelluar ndikimin e saj dhe duke forcuar partneritetet me autoritetet lokale. Komunitet kryesore ku IADK ka punuar për arritjen e qëllimeve të përbashkëta janë:

1. Dragash
2. Drenas
3. Fushë Kosovë
4. Klinë
5. Leposaviq

6. Lipjan
7. Malishevë
8. Mitrovica e Jugut
9. Obiliq
10. Podujevë

11. Prishtinë
12. Skënderaj
13. Shtime
14. Suharekë
15. Vushtri

Në këto komuna, projektet e IADK-së kanë përfshirë një gamë të gjerë aktiviteteve, si trajnime profesionale, mbështetje teknike, ndihmë në zhvillimin e bizneseve të vogla, promovim të bujqësisë organike dhe fuqizim të grupeve të marginalizuara.

Të arriturat kryesore që mund të përmenden për këtë vit!



255 përfitues, nga ku 51% e tyre janë gra/vajza dhe 41% janë nga komunitetet jo shumicë



25.5% e të gjithë përfituesve i takojnë moshës nga 18 deri 35 vjeç




7 projekte e shërbime të menaxhuar në mënyrë të suksesshme nga IADK



614,052 euro të hyra dhe realizuara nga IADK përmes mbështetjes nga donatorë të ndryshëm




25 punonjës (2 praktikantë) të cilët në mënyrë të suksesshme kanë realizuar detyrat në mbështetje të grupeve të synuara



PUNA JONË NË NUMRA

Falë mbështetjes së vazhdueshme nga donatorët, përkrahjes së komunave përkatëse dhe gatishmërisë së përfituesve, IADK ka arritur të realizojë një sërë aktiviteteve me ndikim të rëndësishëm për komunitetet rurale në Kosovë. Aktivitetet e ndërmarra kanë pasur në fokus krijimin e mundësive për gjenerimin e të ardhurave dhe rritjen e punësimit për fermerët, gratë, burrat, të rinjtë dhe të rejtat.

255 Përfitues të mbështetur
përmes granteve dhe trajnimeve



65 Përfitues janë të rinj (18-35 vjeç) ose 25.5%

4 Biznese udhëhequr
me sukses nga gratë



PUNA JONË NË NUMRA



469 Këshilla direkte
të ofruar në teren



13 Trajnine profesionale të
ofruar për 74 pjesëmarrës



30 Pjesmarrës kanë përcjell 5 ditë
trajnine me temën “aftësi të buta”



34 Kandidatë u certifikuan pas
përfundimit të 55 ditë të trajnimeve
për aftësim profesional



30 Studentë përfunduan me
sukses praktikën në punë




10 Studentë pas praktikës
kanë gjetur punë



8 Vizita studimore të
realizuara me sukses me
gjithsej 93 pjesmarrës



4 Panaire Bujqësore
organizuar, ku 38 fermerë
prezantuan produktet e tyre



30 Pjesmarrëse nga grupi
GIGVA kanë ndjekur trajnimet
në përdorimin e kompjuterit
dhe mediave sociale



18 Pjesmarrëse nga grupi
GIGVA kanë përcjellur trajnime
mbi të drejtat pronësore



4 Pjesmarrëse kanë prezantuar
me sukses produktet e tyre në
panairin Agrokos

Më tepër se 100 fermerë kanë arritur të gjenerojnë të ardhura të ndryshme, ndër më kryesorët:



72 fermerë në sektorin e
blegtorisë kanë gjeneruar
të ardhura shtesë nga

1,000 – 1,600€



17 fermerë në sektorin e
perimeve kanë gjeneruar
të ardhura shtesë nga

1,400 – 2,050€



10 fermerë në sektorin e
pemëve kanë gjeneruar
të ardhura shtesë nga

2,000 – 5,200€

Sektori i Perimeve, një thesar për zhvillim të bujqësisë

Viti 2024 ishte një vit i vështirë për kultivuesit e perimeve, sidomos ata që punojnë në fushë të hapur, kjo për shkak të temperaturave shumë të larta gjatë muajve të verës. Këto kushte ekstreme ndikuan negativisht në zhvillimin normal të perimeve, duke çuar në zvogëlimin e rendimentit dhe cilësisë së prodhimit.

IADK ka luajtur një rol të rëndësishëm në lehtësimin e përballjes së fermerëve me kushtet klimatike të pafavorshme, veçanërisht në sektorin e perimeve. Përmes mbështetjes për ndërtimin e serrave për prodhimin e perimeve, IADK ka mundësuar krijimin e kushteve më të kontrollueshme për rritjen e bimëve. Këto serra ofrojnë mundësinë për të menaxhuar dhe përshtatur faktorët klimatikë, duke i mundësuar fermerëve të kontrollojnë temperaturën, lagështinë dhe dritën, dhe si rezultat, të rrisin rendimentin dhe cilësinë e prodhimit.



Në vitin 2024, IADK ka mbështetur 91 fermerë të vegjël në sektorin e perimeve përmes granteve që përfshinin ndërtimin e serrave dhe furnizimin me inpute të nevojshme, pajisje dhe mekanizëm bujqësor. Nga ky total, 52 fermerë janë pajisur me serra dhe inpute përcjellëse, duke rezultuar në shtimin e sipërfaqeve me serra për 0.72 hektarë. Këto serra, me sipërfaqe nga 120 deri në 176 m², kanë ndihmuar fermerët të rrisin si rendimentin, ashtu edhe cilësinë e prodhimit të perimeve.

Përveç serrave, IADK ka mbështetur 39 fermerë me mekanizëm bujqësor, fidane, rrjeta për hijezim dhe pajisje, duke lehtësuar punën dhe rritur të ardhurat e fermerëve të vegjël. Përveç granteve, është ofruar mbështetje profesionale përmes trajnimeve, këshillave dhe monitorimit. Kjo ka përmirësuar njohuritë për kultivimin dhe menaxhimin e serrave, duke siguruar të ardhura mesatare prej 1,400 euro për 17 fermerë me serra 176 m², të cilët kultivojnë specja dhe domate.





Sektori i Perimeve, një thesar për zhvillim të bujqësisë

Një histori suksesi të veçantë nga kultivimi i perimeve në serrë vjen nga z. Faton Muharremi, një fermer nga fshati Çubrelli, Komuna e Skenderajt. Pas aplikimit për grantin për ndërtimin e serrës në shkurt të vitit 2024, Fatonit iu dha mundësia të merrte mbështetje nga IADK. Gjatë vizitës nga komisioni përzgjedhës, ata vërejtën përkushtimin e tij të jashtëzakonshëm ndaj punës dhe kujdesit për familjen e tij 12 anëtarëshe.

Faton kishte një sipërfaqe totale prej 35 ari, por vetëm 5 ari ishin të përshtatshëm për kultivimin e perimeve, ndërsa pjesa tjetër e tokës ndodhej në një terren kodrinor dhe pa mundësi ujitjeje. Megjithatë, ai kishte arritur të kultivonte perime në fushë të hapur çdo vit dhe, para dy vitesh, kishte ndërtuar një serrë të thjeshtë prej 30 m² me një konstruktion druri, ku kultivonte spinaqin.

Duke pasur një interesim të madh për këtë fushë, si dhe duke plotësuar kriteret e përzgjedhjes, komisioni e ka shpallur atë përfitues të grantit. IADK e mbështeti me një serrë të re, me sipërfaqe prej 176m², inpute përcjellëse dhe fidane për kultivimin e perimeve. Si rezultat i kësaj mbështetjeje dhe përkushtimit të palodhur të Fatonit, ai arriti të prodhojë 1860 kg perime cilësore, përfshirë 1260 kg speca dhe 600 kg domate. Nga shitja e këtyre perimeve, ai gjeneroi të ardhura prej 2,058 euro. Përveç kësaj, ai ka mbjellë serrën e tij edhe për sezonin vjeshtor me spinaq dhe qepë, të cilat pritet të sjellin të ardhura shtesë për familjen e tij. Ky sukses është një shembull i ndikimit pozitiv të mbështetjes së IADK-së dhe përkushtimit të fermerëve.

“Ky grant ka qenë një ndihmë e madhe për familjen time, pasi kemi përfituar shumë nga prodhimi i perimeve.

E gjithë familja ka qenë aktive në punët në serrë. Shpresoj të rris sipërfaqen me serrë dhe të rritet kapaciteti i prodhimit.

*Ju falenderoj për përkrahjen!”
shprehet Fatoni*



52 fermerë u mbështetën me serra dhe inpute përcjellëse, duke shtuar sipërfaqet e mbjella dhe përmirësuar rendimentin



39 fermerë përfituan mekanizëm bujqësor, zgjidhje për digjitalizim dhe adaptim ndaj ndryshimeve klimatike



236 këshilla direkte u ofruan nga ekspertët për përmirësimin e praktikave bujqësore dhe menaxhimit të fermave



11 sesione trajnimi teorik u organizuan për ngritjen e kapaciteteve të fermerëve



2 vizita studimore u zhvilluan për të shkëmbyer përvoja dhe mësuar praktikatat më të mira

Kultivimi i pemëve një mundësi e artë për punësim dhe gjenerim të ardhurave

Industria e pemëve në Kosovë luan një rol kyç në rritjen ekonomike dhe bujqësore të vendit. Kosova ka një klimë të përshtatshme për kultivimin e suksesshme të mollës, dardhës, dredhës, mjedrës e të tjera, duke e bërë bujqësinë si një sektor të rëndësishëm dhe me perspektivë. Investimet në teknologji dhe ndihma për fermerët kanë rritur prodhimin, përmirësuar jetesën e familjeve dhe kanë krijuar punësim në zonat rurale.

Kërkesa për prodhime të freskëta nga tregjet ndërkombëtare ka hapur mundësi të rëndësishme eksporti, duke u shëndrruar bujqësinë në burim të vlefshëm të ardhurash. Megjithatë, sfidat si ndryshimet klimatike dhe nevoja për financim mbeten, por potenciali për rritje të mëtejshme të ekonomisë dhe mirëqenies së fermerëve është i madh.



Në këtë kontekst, IADK përmes projekteve të sajë ka ndihmuar në zhvillimin e sektorit të pemëve të imëta, më saktësisht ka mbështetur 10 përfitues nga komuna e Suharekës me shtimin e 1.5 hektar sipërfaqe me dredhëz. Përmes mbjelljes vjeshtore të një viti më parë të dy kultivarëve të kërkuar të dredhës (Alba dhe Albion) me cilësi të klasës A+, kanë mundur që në tregun e Kosovës që në vitin e parë të prodhimit të kemi një total prej 20 ton dredhëz cilësor.

Ekziston një interesim i fermerëve për rritjen e sipërfaqeve në vitet në vijim, të dhënat tregojnë se shumë shpejt këta fermerë do të rrisin sipërfaqet edhe për 5 ari, bazuar edhe në kërkesat e tregut për dredhëz cilësor.



Kultivimi i pemëve një mundësi e artë për punësim dhe gjenerim të ardhurave

Znj. Yrmete Kabashi nga Reshtani, Suharekë, filloi të kultivojë dredhëza pas vështirësive me metodat tradicionale të bujqësisë. Me mbështetje nga IADK, ajo mori grante për fidane, sistemin e ujitjes dhe këshilla për menaxhimin e sëmundjeve. Në vitin e parë, ajo mbolli 15 ari dhe arriti të mbledhë 2,600 kg dredhëza, duke fituar 5,200 euro. Ajo gjithashtu ka ndihmuar fermerët e tjerë me këshilla. Granti jo vetëm që i gjeneroi të ardhura asaj, por gjithashtu krijoi mundësi punësimi për anëtarët e familjes. Yrmete filloi të ndante njohuritë e saj me fermeret fillestar në kultivimin e dredhëzës.

Gjatë rrugëtimit tim kuptova se dredhëza nuk kërkon të prodhohet në sipërfaqe të mëdha për të qenë fitimprurëse, madje edhe një vjelje me produkt cilësor mund të ishte shumë e vlefshme.

Mbështetja e IADK-së nuk ka përfunduar vetëm në kultivimin e dredhëzës, përmes projektit për mbështetjen e minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara, është mbështetur edhe një fermer me pajisje për tharjen e pemëve. Kjo pajisje do ti ndihmojë fermerit që të rrisë vlerën e produktit, do të ndihmojë në diversifikimin e produktit për tregun lokal dhe më gjerë.



Sektori i Blegtorisë



Blegtoria përfaqëson një potencial të jashtëzakonshëm për avancimin dhe zhvillimin e bujqësisë së Kosovës. Ky sektor është i lidhur ngushtë me degë të tjera ekonomike, si prodhimi i ushqimit, përpunimi i produkteve blegtorale dhe tregtia, duke shërbyer si një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë biznese të vogla dhe të mesme. Për më tepër, blegtoria luan një rol kyç në ekonominë e vendit, jo vetëm si burim ushqimi dhe të ardhurash për familjet rurale, por edhe si një faktor që kontribuon në ruajtjen e traditave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale.

Historikisht, sektori i blegtorisë në Kosovë ka qenë kryesisht ekstensiv, me një dominim të fermave të vogla dhe me kapacitete të kufizuara. Megjithatë, vitet e fundit kanë shënuar një ndryshim të dukshëm, një rritje të fermave më të mëdha që operojnë në mënyrë gjysmë-intensive dhe intensive, duke u bazuar në standardet bashkëkohore të prodhimit. Ky transformim ka hapur rrugën për një sektor më konkurrues dhe të orientuar drejt eksportit, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë dhe sasinë e produkteve blegtorale në treg.

Megjithatë, zhvillimi i këtij sektori akoma përballet me disa sfida, të cilat ndikojnë në rritjen dhe modernizimin e përgjithshëm të tij si: potenciali i dobët gjenetik i racave të përdorura, menaxhimi joefikas, mungesa e një brezi të ri fermerësh për të zëvendësuar fermerët e vjetër që vazhdojnë mbarështimin tradicional, si dhe barrierat administrative dhe logjistike për eksport të produkteve blegtorale.

Për të adresuar këto sfida, IADK ka marrë një rol aktiv në përmirësimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të blegtorisë, përmes programit të trajnimeve për Arsimit dhe Aftësim Profesional (AAP) “Teknik i Blegtorisë” në nivelin III sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), të akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), si dhe përmes ofrimit të shërbimeve këshillimore dhe monitorimeve tek fermerët me qëllim të adaptimit dhe zbatimit të teknologjive moderne dhe praktikave të qëndrueshme bujqësore, duke kontribuar kështu në zhvillimin afatgjatë të këtij sektori dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese të fermave, të sasisë dhe cilësisë së produkteve vendore blegtorale në përputhje me standardet për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, të ndryshimeve klimatike dhe kërkesave të tregut.



Sektori i Blegtorisë

Në vitin 2024, IADK mbështeti 78 fermerë/blegtor përmes granteve, trajnimeve dhe shërbimeve këshilluese, fermerë që merren me blegtori, bletari dhe shpeztari.

Një prej tyre është Qëndrim Bilalli nga fshati Stroc, Komuna e Vushtrisë, i cili është i përkushtuar në sektorin e blegtorisë, megjithë sfidat që ai paraqet, si ndryshimet klimatike dhe çmimet e paqëndrueshme.

Qëndrimi ka 13 gjedhe, prej të cilave 8 janë lopë qumështore. Falë mbështetjes nga IADK, ai ka marrë laktofrizë, makinë mjelëse dhe bidon qumështi.

Këto pajisje i kanë mundësuar atij të nënshkruaj kontratë me qumështore, përmirësojë efikasitetin e procesit të mjeljes dhe ruajtjes së qumështit, duke parandaluar humbjen e qumështit dhe duke përbushur standardet e cilësisë. Kombinimi i mbështetjes me grante përmes furnizimit me pajisje dhe ofrimit të këshillave praktike ka mundësuar që, në vitin 2024, Qëndrimi të ketë të ardhurat shtesë me vlerë prej 1,665 €.

Kjo rritje ka ardhur nga subvencionimi i cilësisë së qumështit dhe ruajtja e qumështit në kushte të përshtatshme, përmes përdorimit efikas të laktofrizit, makinës mjelëse dhe praktikave të mira bujqësore. Ky përmirësim ka ndikuar pozitivisht në rritjen e produktivitetit dhe cilësisë së qumështit që ai prodhon, duke kontribuar në zhvillimin e sektorit të blegtorisë.



72 Fermerë të mbështetur me laktofriza dhe pajisje të ndryshme



4 Fermerë janë pajisur me mjete për bletari



2 Fermerë janë mbështetur me pajisje të dedikuara për shpeztari



213 Këshilla direkte



2 Trajnime teorike



4 Vizita Studimore



Sektori i Përpunimit të Ushqimit

Sektori i përpunimit të ushqimit është një shtyllë thelbësore e ekonomisë së Kosovës, duke kontribuar në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik. Megjithatë, sfida e përfaqësimit gjinor mbetet e theksuar, pasi gratë përbëjnë një përqindje më të vogël të fuqisë punëtore. IADK mbështet këtë sektor përmes trajnimeve dhe këshillave, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të tij.

IADK është e akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) dhe e licensuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për ofrimin e trajnimeve në Nivelin 3 për kualifikimet: Konzervues i frutave, perimeve dhe të ngjashme, Qumështar dhe Bërës Embëlsirash bazuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

Programet e IADK-së përfshijnë sigurinë në vendin e punës, praktikat e mira të prodhimit, dhe menaxhimin e mbetjeve. 70% e trajnimeve janë praktike, realizohen në Njësinë e Përpunimit të Ushqimit dhe në bashkëpunim me biznese.

Në vitin 2024, IADK realizoi 55 sesione trajnimesh, me 45 pjesëmarrës, nga të cilët 34 u certifikuan me çertifikata valide të verifikuara nga AKK, duke dëshmuar angazhimin e IADK për përmirësimin e aftësive profesionale.



30 gra kanë ndjekur një trajnim 35-ditor në programin “Bërës ëmbëlsirash”



24 prej tyre janë certifikuar



15 gra kanë marrë pjesë në një trajnim 20-ditor në programin “Qumështar”



10 prej tyre janë certifikuar

IADK, gjithashtu ka ofruar 10 sesione trajnimesh në konzerimin e pemëve dhe perimeve, për gjithësej 10 pjesëmarrëse, nga të cilat 8 ishin të komunitetit serb dhe 2 të komunitetit egjiptian.

IADK ofron një qasje të gjithanshme për fuqizimin e sektorit të përpunimit të ushqimit, duke kombinuar trajnime profesionale, mbështetje me grante, paketim, marketing digjital dhe ndihmë për regjistrimin e biznesit. Gjatë vitit 2024, IADK ka mbështetur ngritjen e katër (4) njësive moderne, dy të përpunimit të qumështit dhe dy në sektorin e bërjes së ëmbëlsirave në komunat e ndryshme, me fokus të veçantë në fuqizimin ekonomik të grave në zonat rurale.



Sektori i Përpunimit të Ushqimit

Përfitueset, Luljeta Hoxha dhe Sabahate Zymeri, pas përfundimit të trajnimeve profesionale në programet e kualifikimit “Qumështar” dhe “Bërës Ëmbëlsirash”, kanë realizuar projekte konkrete në fushën e përpunimit të ushqimit.



Luljeta Hoxha, nga fshati Domanek, Drenas, me përvojë pesëvjeçare në përpunimin e qumështit, ngriti njësinë moderne “Tradita e Djathit Bjeshka” me mbështetjen e grantit nga IADK. Ajo fokusohet kryesisht në prodhimin e djathit dhe synon të zgjerojë kapacitetin duke bashkëpunuar me ferma të tjera për furnizimin me lëndë të parë. “Trajnimet nga IADK më kanë dhënë njohuri dhe motivim për ta zhvilluar më tej idenë time në përpunimin e qumështit,” deklaroi ajo.



Sabahate Zymeri, përfituese nga Shtimja dhe themeluese e “ER Cakes”, ka zhvilluar biznesin e saj të ëmbëlsirave falë mbështetjes nga IADK. Ajo përvetësoi receta dhe teknika moderne, duke optimizuar kostot dhe rritur efikasitetin. Me mbështetje nga IADK, ajo pajisi biznesin me një furrë elektrike profesionale dhe frigorifer vertikal me kapacitet 1200 litra, duke rritur kapacitetin prodhues dhe zgjeruar gamën e produkteve për të përmbushur kërkesat e tregut në rritje.

Përmes kombinimit të trajnimeve profesionale, mbështetjes financiare dhe monitorimit të vazhdueshëm, IADK siguron që produktet e përpunuara nga përfituesit të jenë cilësore dhe të sigurta, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe fuqizimin e sektorit të përpunimit të ushqimit në Kosovë.

Gjatë vitit 2024, organizata IADK, në bashkëpunim me Senior Experten Service (SES) nga Gjermania, organizoi një trajnim profesional të dedikuar për përpunimin e brumit dhe pasticherisë. Në këtë trajnim morën pjesë 10 pjesëmarrës, të cilët përfituan njohuri praktike dhe të avancuara në teknikat e prodhimit. Ky trajnim synoi përmirësimin e proceseve të punës dhe rritjen e cilësisë së produkteve, duke u mundësuar pjesëmarrësve të jenë më konkurrues në tregun vendor dhe atë ndërkombëtar.

4 njësi



2 njësi për prodhimin e
ëmbëlsirave



2 njësi të përpunimit
të qumështit



3 vizita studimore janë realizuar me
pjesëmarrjen e 44 grave nga programi
“Bërës ëmbëlsirash” dhe “Qumështar”

Përfshirja Gjinore

Përfshirja gjinore në Kosovë mbetet një prioritet strategjik kombëtar, duke pasqyruar përkushtimin institucional dhe shoqëror për promovimin e barazisë gjinore. Megjithatë, gratë dhe vajzat, veçanërisht në zonat rurale, përballen ende me sfida të shumta, si mungesa e mundësive ekonomike, diskriminimi social dhe qasja e kufizuar në burime financiare dhe trajnime profesionale.

Në këtë drejtim, IADK synon të fuqizojë gratë dhe vajzat e reja, në veçanti atyre që jetojnë në zonat rurale, duke ofruar programe gjithëpërfshirëse që adresojnë nevojat e tyre specifike. Përmes trajnimeve profesionale, këshillimit të personalizuar, dhënies së granteve, vizitave studimore dhe tryezave të rumbullakëta, organizata ka krijuar mundësi të reja për këtë grup të marginalizuar, duke kontribuar në përmirësimin e gjendjes së tyre socio-ekonomike.

Një shembull i veçantë i këtij angazhimi është grupi GIGVA (Grupi Informal i Grave dhe Vajzave Aktive), i cili vepron në Komunën e Vushtrrisë prej tre vitesh me mbështetjen e IADK-së. Ky grup ka ndihmuar gratë dhe vajzat të zhvillojnë aftësi praktike, të ndërtojnë vetëbesimin dhe të krijojnë rrjete bashkëpunimi për fuqizimin e tyre ekonomik dhe social.

Në tetor 2024, me mbështetjen e IADK-së dhe në bashkëpunim me Komunën e Vushtrrisë, GIGVA realizoi një aktivitet frymëzues për ndërgjegjësimin e kancerit të gjirit. Në Njësinë e Përpunimit të Ushqimit të IADK-së u përgatitën lloje të ndryshme ëmbëlsirash, të cilat më pas u vendosën për shitje në sheshin e qytetit të Vushtrrisë. Ky aktivitet gëzoi përkrahje të gjërë nga qytetarët, të cilët e përkrahën këtë kauzë. Brenda një dite të vetme, u grumbullua një shumë prej 1,216.5 euro, e cila u dedikua për të ndihmuar katër gra nga Vushtrria dhe Mitrovica që përballen me kancerin e gjirit dhe vështirësi ekonomike.

“Trajtimi i kancerit të gjirit është një barrë e rëndë financiare për mua dhe familjen time. Me ndihmën që mora nga IADK do të mbulojë dy muaj të terapisë, por ajo që kisha nevojë më shumë, është për të ditur se ka njerëz që bashkëndejnë me mua dhe më japin forcën për të vazhduar.” – deklaroi një nga përfitueset.



Përfshirja Gjimore

IADK, në bashkëpunim me grupin GIGVA, ka realizuar edhe të tjera aktivitete të dedikuara për fuqizimin e grave dhe vajzave, duke promovuar ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive në komunitet:



Në ditën e përvitshme që shënon 16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës ndaj Grave, është organizuar një ligjërata mbi raportimin e dhunës dhe të drejtat ligjore, nga ku 32 gra e vajza përfituan informata relevante



Në shënim të ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale që mbahet me 15 Tetor, një event me pjesmarjen e 30 grave u ndanë storiet e tyre të suksesit dhe u shpërndanë dhurata simbolike për të nderuar përpjekjet dhe kontributin e tyre në komunitet



Disa nga gratë (4) përfituese të organizatës me sukses kanë promovuar produktet e tyre tradicionale në panairin Agrokos të datës 16 dhe 17 tetor




Panairi Bujqësor në Komunën e Shtimes i mundësoi 18 grave për të promovuar prodhimet e tyre lokale, duke kontribuar në rritjen e dukshmërisë dhe vlerës së produkteve.



Vizita Studimore

IADK organizoi vizita studimore që shërbyen për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira, duke krijuar ura lidhëse midis fermerëve dhe fermave model, pemishteve, si dhe njësive të përpunimit të ushqimit. Këto vizita përfshinë sektorë të ndryshëm, si perimet, blegtorinë dhe përpunimin e ushqimit, duke u mundësuar pjesëmarrësve të njihen me teknologji të reja bujqësore, metoda moderne të kultivimit dhe mundësi të reja për tregti dhe bashkëpunim.



"Vizatat studimore ishin një mundësi e shkëlqyer për të mësuar nga eksperiencat e tjerëve dhe për të përmirësuar praktikën tona bujqësore."

Elfete Ferati nga Vushtrria

Pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime të hapura me ekspertët dhe kolegët e tyre, duke ndarë përvojat personale dhe duke marrë shembuj praktikë që mund të përshtaten në fermat e tyre. Shumë prej tyre vlerësuan rëndësinë e këtyre vizitave, duke theksuar se ato kanë ndihmuar jo vetëm në përmirësimin e praktikave ekzistuese, por edhe në zgjerimin e perspektivës për zhvillim të mëtejshëm të fermave të tyre. Ky angazhim ka rritur motivimin dhe ka krijuar një bazë të qëndrueshme për inovacion dhe progres në sektorin bujqësor.



Panaire

Këtë vit, IADK ka organizuar katër panaire të dedikuara grave të angazhuara në sektorin e përpunimit të ushqimit, duke krijuar një mundësi të veçantë për promovimin e produkteve të tyre tradicionale. Në këtë event morën pjesë 38 gra, të cilat prezantuan një gamë të gjerë produktesh nga sektorë të ndryshëm, përfshirë bulmetin, konservimin e pemëve dhe perimeve, ëmbëlsirat dhe produktet e brumit.



Panairi u shërbeu si një mundësi jo vetëm për ekspozimin dhe shitjen e produkteve, por edhe për ndërtimin e lidhjeve të rëndësishme tregtare me blerësit dhe partnerët potencialë.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të ndajnë historitë e tyre përmes produkteve dhe të frymëzojnë gratë e tjera për të ndjekur rrugën e sipërmarrjes në sektorin e përpunimit të ushqimit.



Falë panairit, arritëm të lidhim kontakte të reja dhe të hapim mundësi të reja për produktet tona.

Arbnore Neziraj nga Shtime

Ky aktivitet kontribuoi në rritjen e dukshmërisë dhe vlerësimit të produkteve lokale, duke nxitur një ndikim pozitiv në fuqizimin ekonomik të grave dhe zhvillimin rural.

Përfshirja e Komuniteteve jo Shumicë

Minoritetet dhe grupet e marginalizuara janë një prioritet kyç i mbështetjes teknike dhe profesionale që IADK ofron për promovimin e barazisë sociale dhe ekonomike në Kosovë. Gjatë vitit, janë ndërmarrë veprime për të përfshirë aktivisht grupet minoritare si romët, ashkalinjtë, egjiptianët, serbët dhe boshnjakët, duke fokusuar në forcimin ekonomik dhe kohezionin social.

IADK ka mbështetur integrimin e këtyre grupeve në tregun e punës dhe sektorin e bujqësisë, duke ofruar trajnime dhe mundësi për zhvillimin e aftësive dhe vetëpunësim.

Gjatë vitit, janë mbështetur 104 individë nga grupe të ndryshme, përfshirë 58 nga komunitetet rome dhe ashkali, 39 nga komuniteti serb dhe 7 nga boshnjak. Po ashtu, IADK ka ofruar trajnime për 10 gra nga komunitetet jo shumicë në sektorët e bujqësisë dhe menaxhimit të biznesit, duke i fuqizuar ato për mundësi punësimi dhe hapjen e bizneseve të suksesshme.



104 përfitues
nga komunitetet
e ndryshme



10 gra nga komuniteti jo
shumicë kanë ngritur njohurit e
të bërit biznes dhe përpunimit
të pemëve e perimeve

Përveç kësaj, IADK ka ofruar programin e subvencionimit të pagave për 42 përfitues duke kontribuar në zhvillimin e aftësive të tyre dhe hapur mundësi punësimi përmes angazhimit 15-ditor në kompani.



42 përfitues janë mbështetur me
subvencionim të pagës për 15 ditë pune

**Tre individë kanë siguruar punësim afatgjatë pas periudhës 15-ditore të mbështetjes,
duke dëshmuar suksesin e programit.**



**Falë subvencionimit të pagave, fituam përvojë dhe
siguruam punë të përhershme në Agrounion, duke mbajtur
familjet tona dhe kontribuar në komunitet si model për të
tjerët. – Punëtorët nga komuniteti Ashkali.**

Fuqizimi teknik dhe profesional i organizatës IADK

Gjatë vitit 2024, IADK ka përmirësuar ndjeshëm kapacitetet teknike dhe profesionale për ofrimin e trajnimeve praktike në sektorët e ndryshëm të prodhimit primar, kjo e arritur falë mbështjetjes së donatorëve, e në veçanti nga BftW. Një hap i rëndësishëm ishte blerja e një ngastre prej 2300 m², ku u ndërtua një serrë moderne 200m², e pajisur me teknologji të avancuar për kultivimin e perimeve. Serra përfshin një sistem për grumbullimin e ujit të shiut, inkubator për farat dhe një sistem digjital për ujitje dhe ajrosje që rregullon automatikisht parametrat klimatikë.

Në vitin 2024, u zhvilluan trajnime praktike për 30 fermerë, duke mësuar hapat e kultivimit të perimeve dhe kujdesin gjatë vegetacionit. Pjesa tjetër e ngastrës u shfrytëzua për një pemishte demonstruese janë mbjellë kultura të ndryshme të pemëve dhe bimëve mjekësore, të cilat menaxhohen me një sistem digjital të ujitjes.

Kjo infrastrukturë moderne ndihmon IADK-në të transferojë njohuritë praktike tek fermerët për përmirësimin e kultivimit të pemëve dhe perimeve.

IADK ka kontribuar në zhvillimin profesional të stafit të saj, duke synuar ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e performancës në fushat kyçe të veprimtarisë së organizatës. Për këtë qëllim, është organizuar një vizitë studimore e kombinuar me trajnim profesional e përcjell nga 13 anëtar të stafit të IADK-së. Gjatë kësaj vizite/trajnimi dy ditor, stafi pati mundësinë të përfitoj nga përvoja e një eksperti të njohur në çështjet gjinore. Trajnimi u fokusua në fuqizimin e grave në aktivitete socio-ekonomike dhe promovimin e barazisë gjinore në tregun e punës.

Ky aktivitet synon të pajisë pjesmarrësit me njohuri dhe aftësi konkrete për të integruar perspektivën gjinore në projektet dhe aktivitetet e IADK-së, duke përmirësuar ndikimin në komunitete dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm. Përmes qëllimeve dhe aktiviteteve të tilla, IADK synon të forcojë ekspertizën e saj dhe të thellojë ndikimin pozitiv në komunitet.



Praktikat dhe Punësimi i Studentëve

Në Kosovë, ku të rinjtë përfaqësojnë mbi 50% të popullsisë, roli i tyre në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik është i një rëndësie të veçantë. Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032 thekson sfida kryesore për këtë grupmoshë, si mospërputhja midis aftësive të fituara gjatë studimeve dhe kërkesave të tregut të punës, si dhe mungesa e qasjes në financa, e më që rastë kufizon të bërit biznes dhe vetëpunësimin e të rinjëve.

Megjithatë, rritja e bizneseve në sektorin agrobujqësor dhe teknologjisë ushqimore në vitet e fundit, kanë rritur kërkesat për profesionistë të kualifikuar. Përballë kësaj dinamike, përgatitja dhe integrimi i profesionistëve të rinj mbetet një sfidë komplekse në të gjithë Kosovën.

Për të adresuar këto sfida, IADK ka zhvilluar programe praktike për studentët e bujqësisë dhe teknologjisë ushqimore, duke ofruar një kombinim të praktikës tre mujore në kompani bujqësore dhe agropërpunuese, përcjellur me një trajnim pesë-ditor për zhvillimin e aftësive të buta. Aftësi si komunikimi, të menduarit kritik dhe orientimi në karrierë të përfshira në këtë trajnim, janë thelbësore për përgatitjen dhe suksesin profesional të të rinjve.



Gjatë vitit 2024, 30 studentë nga drejtimit e Teknologjisë Ushqimore, Prodhimtarisë Bimore, Bujqësisë dhe Mjedisit morën pjesë në këtë program. Përmes këtij programi, 10 studentë arritën të siguronin punësim, duke kontribuar në uljen e papunësisë së të rinjve dhe krijimin e një fuqie punëtore të aftë dhe konkurruese.

Ky program i IADK synon të lehtësojë tranzicionin e studentëve nga arsimi formal në tregun e punës dhe të adresojë mospërputhjen e aftësive, duke ndihmuar të rinjtë të bëhen pjesë aktive dhe produktive e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Praktikat dhe Punësimi i Studentëve

Një nga përfitueset e suksesshme të këtij programi është Leona Bruti, e diplomuar në Teknologji Ushqimore me Bioteknologji nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë në vitin 2024. Pas diplomimit, Leona u bë pjesë e programit tre-mujor të praktikës profesionale të organizuar nga IADK, ku pati mundësinë të zbatojë njohuritë e saj teorike në një mjedis praktik.

Gjatë kësaj periudhe, Leona u përfshi në aktivitete kyçe të teknologjisë ushqimore, duke treguar një nivel të lartë profesionalizmi dhe përkushtimi. Puna e saj e palodhur dhe aftësitë e fituara gjatë praktikës i siguruan një vend pune si Teknologe Ushqimore në “Qumështoren Bylmeti”, ku ajo vazhdon të punoj me sukses, duke luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë dhe inovacionin e produkteve të kompanisë.



80 kandidatë aplikuan për programin e praktikës në punë



30 u përzgjedhën për të marrë pjesë në një praktikë pune



29 prej tyre ishin gra/vajza

1 prej tyre ishte burrë/djalë



Nga 30 kandidatët që përfunduan praktikën, 10 prej tyre arritën të sigurojnë vende pune



Raporti Vjetor 2024

“Kjo përvojë më ndihmoi të lidh njohuritë teorike me ato praktike dhe të përshtas aftësitë me kërkesat e industrisë ushqimore. Sot kam një kontratë pune që më siguron të ardhura të qëndrueshme për mua dhe familjen time,” shprehet Leona.

Ngritja e Kapaciteteve Profesionale të Stafit përmes Trajnimeve mbi Barazinë Gjinore


Në nëntor 2024, organizata IADK realizoi një vizitë studimore në Bogë, Rugovë, me synim forcimin e kapaciteteve të stafit në adresimin e sfidave gjinore dhe promovimin e përfshirjes së grave në tregun e punës.

Gjatë kësaj vizite, pjesëmarrësit ndoqën trajnimin “Stimulimi i përfshirjes së grave drejt barazisë gjinore në tregun e punës në Kosovë,” ku u trajtuan sfidat kryesore, mundësitë për kohezion social dhe strategjitë për rritjen e pjesëmarrjes aktive të grave në zhvillimin ekonomik. Sfida dhe mundësi për kohezion social.” Trajnimi theksoi rëndësinë e:

- ✓ Edukimit dhe ndërgjegjësimin mbi barazinë gjinore;
- ✓ Fuqizimit ekonomik të grave si mekanizëm për zhvillim të qëndrueshëm;
- ✓ Përdorimi i gjuhës gjithëpërfshirëse për komunikim të hapur dhe të barabartë.

Në përfundim të aktivitetit, pjesëmarrësit ndanë ide dhe propozime konkrete për projekte që mundësojnë një rol më aktiv të grave në vendimmarrje dhe zhvillimin ekonomik lokal.

IADK mbetet e përkushtuar në krijimin e mundësive të barabarta dhe fuqizimin e grupeve të marginalizuara, duke vazhduar të promovojë zhvillimin inkluziv dhe të qëndrueshëm në komunitetet rurale të Kosovës.



Trajnim mbi Menaxhimin e Rezistencës ndaj Klimës

Dy eksperte të IADK-së kanë ndjekur trajnim nga **German Sparkassenstiftung** mbi “**Menaxhimin e Rezistencës ndaj Klimës.**” Pas trajnimit gjashtëditor, ekspertet organizuan tre cikle trajnimesh për gratë rurale në zyret e IADK-së, me 15 pjesëmarrës në secilin grup, duke fuqizuar ato për të përballuar sfidat e ndryshimeve klimatike.

Si rezultat i suksesshëm i këtij procesi, të dyja ekspertet, fituan certifikimin nga German Sparkassenstiftung, duke u njohur si trajnuese të licencuara. Kjo arritje përforcon kapacitetet institucionale të IADK-së për të vazhduar ofrimin e trajnimeve me standarde të larta dhe për të kontribuar në fuqizimin ekonomik dhe qëndrueshmërinë klimatike të komuniteteve rurale në Kosovë.



Përfitimet nga Trajnimet

- ✓ **IADK:** Rritje e kapaciteteve institucionale në fushën e qëndrueshmërisë klimatike dhe fuqizimit të grave, si dhe forcim i rolit të organizatës në zhvillimin rural të qëndrueshëm.
- ✓ **Fermerët:** Përvetësuan teknika për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, menaxhimin e resurseve dhe zhvillimin e biznesit bujqësor, ndërsa gratë rurale fituan aftësi për role më aktive në komunitet.

Në të ardhmen, këto trajnime do të bëhen pjesë e rregullt e projekteve të IADK, duke kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve të grave rurale dhe krijimin e mundësive ekonomike për t'u përballur me ndryshimet klimatike.

Shërbimet e ofruar nga IADK

IADK, përveç zbatimit të projekteve të financuara nga donatorë të ndryshëm, ka ofruar shërbime të specializuara për partnerë dhe donatorë të angazhuar në zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë. Aktivitetet e saj janë fokusuar në përmirësimin e kapaciteteve teknike të fermerëve, promovimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe rritjen e efikasitetit në prodhim dhe përpunim ushqimor. Përmes qasjeve inovative dhe bashkëpunimit strategjik, IADK ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në adresimin e sfidave kryesore të sektorit.

1. Projekti Fuqizimi i Ekonomive Rurale në Bujqësi (EREA)

Ky projekt, zbatohet nga Caritasi Zviceran në Kosovë dhe financohet nga Austrian Development Cooperation (ADC) dhe komuna të ndryshme të Kosovës, projekti synon zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomive rurale. IADK ka ofruar shërbime dhe ekspertizë të specializuar për:

- Mbështetje teknike për realizimin e projektit
- Zhvillimin e sistemit të tregut
- Monitorimin dhe matjen e rezultateve
- Këshillimin për bujqësinë organike dhe certifikimin organik



2. Projekti Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë

Financuar nga Danish Refugee Council (DRC) dhe zbatuar nga IADK, ky projekt është fokusuar në zhvillimin e bujqësisë në komunat e regjionit të Prishtinës dhe Mitrovicës, me fokus te komunitetet jo shumicë. Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Hulumtim të tregut dhe identifikimin e sektorëve prioritarë
- Mbështetje për komunitetet jo shumicë në krijimin e mundësive të reja ekonomike, punësim dhe gjenerim të të ardhurave



3. Projekti Farat e Fuqizimit – Gratë në Bujqësi

Mbështetur nga Fondacioni Jahjaga, ky projekt ka për qëllim fuqizimin profesional dhe ekonomik të grave të komunitetit jo shumicë në fshatrat e Klinës. Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Trajnime të specializuara në përpunimin e ushqimit dhe menaxhimin e biznesit



4. Projekti Aktiviteti i USAID-it për Zhvillimin e Fuqisë Punëtore të Udhëhequr nga Sektori Privat

Ky projekt synon rritjen e produktivitetit, të ardhurave dhe punësimit për fermerët dhe akterët e tregut, përmes:

- Qasjes në teknologji të avancuar
- Trajnimeve për zhvillimin e aftësive teknike
- Hapjes së mundësive për tregje të reja dhe të qëndrueshme



Parneritetet ndërkombëtare

IADK ka krijuar dhe zhvilluar një rrjet të fuqishëm partneritësh, si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar. Duke bashkëpunuar me organizata, institucione dhe ekspertë të ndryshëm, IADK integron me sukses kontributet dhe resurset e këtyre partnerëve në realizimin e misionit të saj.

Ky mision përqendrohet në avancimin e sektorit të bujqësisë, duke promovuar praktika inovative dhe të qëndrueshme, mbështetjen e diversitetit në prodhimtarinë bujqësore dhe përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme shoqërore, veçanërisht të atyre më pak të përfaqësuara. Përmes këtij rrjeti bashkëpunimi, IADK synon të forcojë zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të komuniteteve rurale, duke ndërtuar një bazë të qëndrueshme për të ardhmen e bujqësisë në Kosovë.

IADK ofron shërbime këshillimore profesionale të standardeve të larta, duke bashkëpunuar ngushtë me një rrjet të gjerë partnerësh ndërkombëtarë dhe lokalë. Partnerët kryesorë ndërkombëtarë përfshijnë:

1.Senior Experten Service (SES): Një organizatë vullnetare nga Gjermania, e specializuar në ngritjen e kapaciteteve përmes edukimit dual në sektorin e përpunimit të ushqimit. Kontributi i SES ndihmon në përmirësimin e aftësive profesionale dhe transferimin e njohurive bashkëkohore.

2.Forumi Evropian për Shërbimet Këshillimore Bujqësore dhe Rurale (EUFRAS): Një rrjet evropian që bashkon shërbimet këshillimore publike për bujqësinë dhe zhvillimin rural. IADK është anëtare e këtij forumi që nga viti 2016, duke marrë pjesë aktive në shkëmbimin e përvojave dhe qasjen ndaj inovacioneve në sektorin bujqësor.

3.Rrjeti i Shërbimeve Këshillimore të Evropës Juglindore (SEASN): Një rrjet rajonal, themeluar në Bullgari në vitin 2015, që synon fuqizimin e shërbimeve këshillimore në bujqësi për sektorin publik, privat dhe shoqërinë civile në Evropën Juglindore.


Në nivel lokal, IADK është një anëtare e rëndësishme e Platformës CiviKos, e cila promovon bashkëpunimin ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve publike, si dhe Rrjetit të Grave të Kosovës, duke mbështetur pjesëmarrjen dhe fuqizimin e grave në zhvillimin e komuniteteve.

Përmes këtij rrjeti të gjerë bashkëpunimi, IADK synon të ofrojë shërbime të personalizuar dhe të efektshme që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm bujqësorë e ekonomik, përmirësojnë jetesën rurale dhe promovojnë përfshirjen shoqërore.



Shpenzimet e IADK-së nga projektet dhe grantet


#	Emri i Donatorit/Partnerit	Emri i Projektit	Shuma €	Përqindja %
1	Bread for the World - BftW Komunat (Vushtrri & Skenderaj) Përfituesit e projektit	Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës	204,641 26,940 12,799	42%
2	Organizata Feministe e Paqes-FRIEDA Komunat (Vushtrri, Shtime) Përfituesit e projektit	Fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjve, që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet aktiviteteve bujqësore dhe përpunimit të ushqimit	110,000 10,734 6,419	22%
3	GIZ	Promovimi ekonomik për të stabilizuar tregun e punes	23,827	4%
4	Këshilli Danez për Refugjatë - DRC	Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë - Faza Fillestare	12,729	2%
5	Këshilli Danez për Refugjatë - DRC	Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë - Faza Implementuese	176,022	30%
Total			584,110	100%



Shënim: Të dhënat janë paraqitur mbi shpenzimet e bëra për vitin 2024, ndërsa të hyrat janë njohur në raport me shpenzimet e bëra referuar projekteve.

Të hyrat e IADK-së nga shërbimet

#	Emri i Partnerit	Emri i Projektit	Shuma €	Përqindja %
1	Jahjaga Foundation	Farat e Fuqizimit: Gratë në Bujqësi	9,287	31%
2	Caritas Switzerland	Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik rural	10,625	35%
3	Komunat: Vushtrri, Skënderaj, Shtime	Shërbimet këshillimore dhe trajnimet për fermerë	10,030	34%
Total			29,942	100%



Mirënjuhje për stafin

IADK shpreh një falënderim të thellë dhe të sinqertë për stafin e saj, praktikantët dhe bordin drejtues, për kontributin e tyre të pakrahasueshëm dhe për realizimin e një viti të suksesshëm, i cili ka ndihmuar në avancimin e bujqësisë dhe në përmirësimin e jetesës së komunitetit.

Bordi drejtues



Shyqyri Hyseni



Myrvete Badivuku



Xhavit Merovci

Stafi i IADK-së



Zenel Bunjaku
Drejtör Ekzekutiv



Edita Mahmuti
Menaxhere e Projektit



Sylejman Bunjaku
Menaxher i Projektit



Ylberinë Baliu
Menaxhere e Projektit



Basri Pulaj
Koordinator i Programit



Djellza Zejnullahu
Menaxhere e Projektit



Besnik Demiri
Menaxher i Projektit



Egzona Hajra
Zyrtare e Projektit



Halit Gashi
Inxhinjer për Bujqësi



Esra Kurshumlija
Zyrtare e Projektit



Ardian Jashari
Menaxher i Financave



Adisa Osmani
Zyrtare për Prokurim




Selatin Emini
Asistent Teknik



Artiola Xhaka
Zyrtare e Projektit



Leonora Hajra
Inxhinjere për Blegtori



Gëzim Murseli
Inxhinjer për Bujqësi



Elheme Shala
Asistente e Financave



Novica Markovic
Inxhinjer për Bujqësi



Hanumshahe Zeneli
Asistente e Projektit



Albesa Beqiri
Teknologe e Ushqimit



Xhentiana Zeka
Asistente e Bujqësisë




Ferki Surdulli
Mirëmbajtës i Objektivit




Ilmihate Surdulli
Mirëmbajtëse e Objektivit



Petrit Koci
IT



Donika Bunjaku
Praktikante e Projektit



Ardita Abazi
Praktikante e Projektit

Mirënjohje për donatorët dhe partnerët

Ju falënderojmë për mbështetjen tuaj të vazhdueshme në përpjekjet tona për të kontribuar në zhvillimin e bujqësisë në Kosovë.

Donatorët tanë



Partnerët tanë



Adresa:

 Sfaraçak i Ulët, Rr. Miran Xhafa,
nr.11, 42,000 Vushtri, Kosovo

Website:

 www.iadk.org

Mediat Sociale:

 facebook.com/iadk.org

 <https://www.linkedin.com/company/iadkorg>

 <https://www.youtube.com/@iadk8611>

Kontakti:

 +383 49 777 046
 +383 44 777 036

 info@iadk.org



Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!